



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:000212
Datë: 16.08.2023
Numri i dokumentit: 04590950

Pml.nr.411/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj, kryetare e kolegjit, Rasim Rasimi dhe Valdete Daka anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, në çështjen penale kundër të pandehurit R. S., për shkak të veprave penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe manipulimi i provave nga neni 389 par. 1 të KPRK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtëses së të pandehurit av. Sahadete Gashi, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PPS.nr.7/2023 të datës 29.6.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special, PN.1.S.nr.134/2023, të datës 26.7.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 16.8.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtëses së të pandehurit R. S., ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PPS.nr.7/2023 të datës 29.6.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special, PN.1.S.nr.134/2023, të datës 26.7.2023, ashtu që ndaj të pandehurit R. S. caktohet masa e paraqitjes në Stacion më të afërt Policor, 2 (dy) herë në javë, çdo të hënë dhe të premte në ora 10:00.

II. Detyrohet i pandehuri R. S., që të lajmërohet në stacionin policor më të përafërt vendbanimit të tij 2 (dy) herë në javë, çdo të hënë dhe të premte në ora 10,00.

III. Ndaj të pandehurit R. S., Gjykata mund të urdhërojë paraburgim nëse i pandehuri shkel vendimin dhe nuk i përmbahet obligimeve sipas këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PPS.nr.7/2023 të datës 29.6.2023, të pandehurit R. S. për shkak të veprave penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK dhe manipulimi i provave nga neni 389 par. 1 të KPRK, ia ka vazhduar masën e paraburgimit për 2 (dy) muaj ashtu që sipas këtij aktvendimi masa e paraburgimit, të pandehurit do t'i zgjasë nga data 6.7.2023 e deri me datën 6.9.2023, konform nenit 184 par.1 nën par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti Special, me aktvendimin PN.1.S.nr.134/2023, të datës 26.7.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit R. S. dhe aktvendimin e ankimuar e ka vërtetuar.

Kundër këtij aktvendimi, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërie ka paraqitur mbrojtësja e të pandehurit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 173, 184 dhe neni 187 par. 2 pika 2.1 të KPP, shkeljes së nenit 5 par. 4 dhe 6 par. 1 të KEDNJ, shkeljes së nenit 29 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që kërkesa të aprovohet si e bazuar, të ndryshohen aktvendimet e kundërshtuara dhe të pandehurit t'i ndërpritet paraburgimi ose t'i caktohet ndonjë masë tjetër të paraparë me nenin 171 të KPP.

Kryeprokurori i Shtetit, me parashtresën KMLP.III.nr.171/2023 datë 15.8.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtëses së të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa gjeti se:

- Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është a bazuar.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, pretendimet e mbrojtëses së të pandehurit R. S. janë të bazuara ngase, konform dispozitës së nenit 187 par. 2 pika 2.1 të KPP, para ngritjes së aktakuzës, paraburgimi nuk mund të zgjasë më shumë se katër (4) muaj kur procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme deri në pesë (5) vjet burgim, dhe tetë (8) muaj kur procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme me më shumë se pesë (5) vjet burgim. Paragrafi 5 i po kësaj dispozite ligjore (nenit 187 të KPP) parasheh se nëse aktakuza nuk ngritët para kalimit të afateve të parapara në paragrafin 2 , 3 dhe 4 të këtij neni, i paraburgosuri lirohet.

Siç del nga shkresat e lëndës, i pandehuri ndodhet në paraburgim nga data 6.1.2023, dhe siç me të drejtë ka potencuar edhe mbrojtësja e të pandehurit, janë tejkaluar afatet e parapara ligjore nga dispozita e cekur më lartë.

Nëse i pandehuri R. S., nuk vepron sipas urdhrorit nga dispozitivi i këtij aktgjykimi dhe nuk paraqitet në Stacionin Policor në afatin e caktuar, ndaj tij do të urdhërohet paraburgimi konform nenit 176 par. 4 të KPP.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të nenit 438 par. 1 nën par 1.1 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË
Pml.nr.411/2023 më 16.8.2023

Bashkëpunëtorja profesionale
Qefsere Berisha

Kryetarja e kolegjit
Mejreme Memaj